



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 528/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik: “ARAD 94” sh.p.k. – Prishtinë, kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull: “Ndërtimi i objektit të Ambulancës së Mjekësisë Familjare në Obrançë”, me nr. prok. 615/17/3761/521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Podujevë, më datë: 02.02.2018, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “ARAD 94” sh.p.k. – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i objektit të Ambulancës së Mjekësisë Familjare në Obrançë”, me nr. prok. 615/17/3761/521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Podujevë.

II. ANULOHET njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull: “Ndërtimi i objektit të Ambulancës së Mjekësisë Familjare në Obrançë”, me nr. prok. 615/17/3761/521, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Podujevë dhe lënda kthehet në **Ri-vlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: "ARAD 94" sh.p.k. – Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 14.08.2017.

Hapja e ofertave është bërë me dt: 04.09.2017, ku kanë marrë pjesë 4 (katër) operator ekonomik.

Letra standarde për Operatorin Ekonomik: "ARAD 94" sh.p.k. – Prishtinë, si tenderues e eliminuar nga Autoriteti Kontraktues, është dërguar me dt: 20.10.2017.

Njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit nga Autoriteti Kontraktues është bërë me dt: 14.12.2017.

Kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit operatorët ekonomik: "ARAD 94" sh.p.k. – Prishtinë, me dt: 18.12.2017, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt: 19.12.2017, autoriteti kontraktues ka marr vendim dhe refuzon kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik: "ARAD 94" sh.p.k. – Prishtinë.

Operatori ekonomik ankues: "ARAD 94" sh.p.k. – Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 22 Dhjetor 2017, me nr. 528/17, kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit, me titull: "Ndërtimi i objektit të Ambulancës së Mjekësisë Familjare në Obrancë", me nr. prok. 615/17/3761/521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Podujevë.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 6.1.2, 7.1.2.6, 10.6, 28.9, 43, 54.1.1 dhe 1.2, 59.2.3.4, 69, 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 18.3, 18.4, 36.2.3.16.17, 39.8, të UOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 28.12.2017, ka autorizuar ekspertin shqyrtuese- profesionale, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja Shqyrtues në raportin e dt: 09.01.2018, në lidhje me pretendimet ankimore të OE: "ARAD 94" sh.p.k. – Prishtinë, ka sqaruar:

Ky aktivitet i prokurimit është publikuar nga autoriteti kontraktues me procedurë të hapur. Lloji i kontratës është pune, kontratë publike vlere e madhe. Ne dosjen e tenderit janë dhënë informata përkatëse lidhur me kontratën në fjalë.

Dosja përfshinë të gjitha termat dhe kushtet materiale të sajë, procedurat e zbatueshme të prokurimit, kërkesa të aplikueshme të përshtatshmërisë dhe kriteret e përzgjedhjes. Kriteri i dhënies së kontratës në harmoni me dispozitat e LPP-së

Në ekspertizë 422/17 të dorëzuar me 10.11.2017 si ekspert profesional i prokurimit të caktuar në atë lëndë kam konstatuar se pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues se ka pasur shkelje të nenëve Neni 6 pika 1,2; Neni 7 pika 1,2, 6; Neni 10 pika 6; Neni 43; Neni 54 pika 1.1 ,1.2 ; Neni 59 pika 2, pika 3, pika 4 Neni 69 Neni 72

-Rregullat dhe UDHEZUESI OPERATIV PËR PROKURIM PUBLIK Nenin 18 pika 18.3, 18.4

Neni 36 pika 36.2, 36.3, 36.16, 36.17 dhe Neni 39 pika 39.8 për të cilat shkelje OE ankues kishte pretenduar edhe në ankesën e parë se këto nene janë shkelur nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Podujevës janë të bazuara , dhe pas konstatimit se ka pasur shkelje i kam propozuar panelit shqyrtues që lëndën ta kthejë në Rivlerësim.

AK Komuna e Podujevës prapë edhe pas vendimit të OSHP-ës Nr.422/17 të datës 05.12.2017 ku aprovohet si e bazuar ankesa e OE ankues "ARAD 94 Sh.P.K", dhe Pas konstatimeve se ka pasur shkelje të LPP-ës dhe të nenëve të lartcekura , AK Komuna e Podujevës i është kërkuar që ky aktivitet i prokurimit të kthehet në Rivlerësim .

AK nuk ka respektuar vendimin e datës 05.12.2017 me arsyetimin se nuk ka buxhet për këtë aktivitet të prokurimit që paraqet një shkelje të radhës nga ana e AK Komuna e Podujevës, të LPP-ës neni 62 "Përfundimi i aktivitetit të prokurimit" dhe neni 44 "Ndërprerja e procedurave të prokurimit" pika 44.7 dhe 44.8 sipas Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik ,ku askund nuk parashihet një arsyetim i tillë, marr parasysh se AK Komuna e Podujevës lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ka shpallur fitues dhe ka publikuar edhe Njoftimin për Dhënie të Kontratës që i bie se ka pasur buxhet të ndarë për këtë aktivitet prokurimi.

Pas konstatimeve të lartcekura propozoj që të obligohet AK Komuna e Podujevës që ky aktivitet i prokurimit të kthehet në Rivlerësim.

Eksperti profesional i Prokurimit në konstatimet e cekura në ekspertizë mendon që Autoriteti Kontraktues – Komuna e Podujevës, për aktivitetin e prokurimit për "Ndërtimi i objektit të Ambulancës së Mjekësisë Familjare në Obrançë", me nr. Prokurimi : 615/17/3761/521, nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së.

Prandaj eksperti profesional i prokurimit i propozon panelit shqyrtues që ta anuloj Njoftimin për Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit dhe ky aktivitet i prokurimit të kthehet në Ri-vlerësim, njëherit i propozon panelit shqyrtues, që ankesa e OE ankues të aprovohet si E-Bazuar.

Gjithashtu eksperti profesional rekomandon AK-së, që gjatë rivlerësimit të zbatohen në tërësi dispozitat e LPP-së.

Autoriteti Kontraktues – Komuna Podujevë, me datë: 11.01.2018, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues: “ARAD 94” sh.p.k. – Prishtinë me datë: 09.01.2018, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën 02.02.2018, pa praninë e palëve konform nenit 26.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të OSHP-së dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se për këtë aktivitet të prokurimit ka pasur ankesë më parë, ku ankues ka qenë i njëjti operator ekonomik dhe për atë ankesë paneli shqyrtues ka lëshuar një vendim me nr.422/17 të dt:05.12.2017, ku i është aprovuar si e bazuar ankesa këtij operatori ekonomik dhe lënda është kthyer në rivlerësim, pasi që ankesa ka qenë kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Paneli shqyrtues sqaron se pas rivlerësimit, autoriteti kontraktues ka anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se është vonuar përfundimi i kësaj procedure të prokurimit, se nuk ka kohë të punohet dhe nuk kanë planifikuar mjete për vitin 2018, mirëpo në lidhje me këtë arsye, paneli shqyrtues konstaton se kjo arsye e anulimit është e pabazuar dhe është në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe me nenin 44.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik. Paneli shqyrtues sqaron se për veprime neglizhente të autoritetit kontraktues nuk mund dhe nuk duhet të pësojnë operatorët ekonomik.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran MILENKOVIĆ



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - "Komuna e Podujevës"

1x1 OE - "ARAD 94" sh.p.k. – Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.